

NEBIAL 3%, SPRAY NASAL



Solucion kripor hipertonic 3% në pH fiziologjik me acid hialuronik

Ka një veprim dekongjestionues në mukozën e hundës dhe ka efekt fluidizues në mukus. Ndihmon drenimin e sekrecioneve, ndaj përdoret për mbajtjen pastër të kavitetit të hundës, në ftohje, në rinite alergjike, në rinosinuzite, në sinuzite. Liron hundët e bllokuara duke përmirësuar frymëmarrjen. Prania e acidit hialuronik e bën të përshtatshëm për t'u administruar tek fëmijët. Acidi hialuronik është një substancë natyrale e prodhuar nga organizmi ynë, që ka funksion hidratimin e indeve. Ngjitja në sipërfaqen e mukozës mban ujin në mënyrë fiziologjike në formën e një shtrese mbrojtëse që lehtëson mukozën e irrituar.

Përmbajtja: solucion hipertonic 3% dhe acid hialuronik

Nuk ka konservantë.

Frekuenca e përdorimit:

Latantët: 1 aplikim në naris(njeren vrimë të hundës) 1-2 herë në ditë.

Fëmijët: 1-3 aplikime në naris 2-3 herë në ditë.

Adultët: 2-4 aplikime në naris 3-4 herë në ditë.

Nuk përdoret:

Në rast të hipersensibilitetit ndaj njërit prej përbërësve .

Produkti duhet të përdoret vetëm mbi mukozën e padëmtuar me integritet anatomik.

Nën fëmijët nën 1 vjec, përdorimi duhet të jepet me rekomandimin e mjekut.

Mos e përdorni në fëmijët më pak se 3 muajsh.

Në rast të reaksioneve të padëshiruara ndaloni përdorimin dhe kontaktoni mjekun.

Efekte të padëshiruara:

Nuk janë vënë re dhe as nuk janë parashikuar efekte anësore të lidhura me produktin. Provat mbi produktin nuk kanë evidentuar fenomene të hipersensibilitetit ose efekte të tjera anësore. Nebial 3% janë të një sigurie të provuar dhe lejojnë përdorim të përsëritur.

Paketimi :

Bombulë spray 100 ml.

Bombula (Bag-On-Valve-con applicatore) nuk dëmton shtesën e ozonit sepse përdor ajër si gaz propellent.